



Pranuar / Dorezuar Punimja/Prodato Received/Delivered	29.12.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SPAMSHICK	7722/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1533/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ardita Percuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, sipas ankesës me numër A.nr.1533/2023 të datës 18.12.2023 të parashtruar nga ankuesja të cilën me autorizim e përfaqëson Av. kundër organit të punësimit: Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike *‘shkelje e të drejtës në pagë’*, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.12.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1533/2023, e datës 18.12.2023, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Nëpunësja civile (tutje vetëm ankuesja), e punësuar në Komunën e Gjilanit, më datë 11.12.2023 përmes Postës së Kosovës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar në Këshill me datë 18.12.2023, me pretendimin së sistemi i ankueses në klasën profesionale 3 është në kundërshtim më dispozitat e Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, për faktin se pozita gjeodet është pozitë specialistike, andaj edhe ankuesja duhet të sistemohet sipas shtojcës 10.7 pika 10.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjilanit, ndërsa kjo e fundit, më datë 29.12.2023, ka përcjellë shkresat ndërlidhur me çështjen në shqyrtim dhe vendosje.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankueses është e parakohshme, sepse:

Nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesja është e punësuar në Komunën e Gjilanit dhe se e njëjta sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.02-016/01-003959/22 të datës 12.04.2022 ushtron pozitën e punës "Teknik i Gjeodezisë", në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Më tej, nga shkresat e lëndës, rezulton se ankuesja ka realizuar koeficient gjashtë (6) të pagës-sipas sistemit të vjetër të pagave, ndërsa, në muajin shkurt 2023, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ankuesja është klasifikuar në klasën "Profesional 3", me koeficient të pagës Gj43-3.96/415.80/1.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se është dashur të kategorizohet sipas shtojcës me numër 10.7 pika 10, me koeficient 6.54 në grupin Specialistë, bazuar në Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, e jo siç është kategorizuar në klasën profesional 3, e njëjta po ashtu kërkon që ti bëhet kompensimi i diferencës në pagë në mënyrë retroaktive për periudhën shkurt-shtator.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Gjilanit ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankueses në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së saj të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve, të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë se me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, pikën 5 dhe 6 të Vendimit Nr. 04/128, të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Vendimit Nr.17/162 të datës 27.09.2023, institucionet e administratës publike janë të obliguara që ta përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjësisht deri me datë 31.12.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankueses, për kategorizimin e pozitës së saj në kategorinë për emërtimin Specialistë sipas koeficientit 6.54, dhe si e tillë, në këtë fazë, nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritior. Rrjedhimisht, e njëjta, është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar më lartë, ankueses do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së saj të punës.




Kështu që, mbështetur në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7, i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1533/2023

Ardita Percuku-SHYTI


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit me autorizim të ankueses Av.
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

